



Elite Travel Agency

EKSPLORO



BOTËN

UDHËTIM NË ISLANDË
19 MAJ 2026



FLUTURIMET

Fluturimi Shqipëri – Islandë 19 Maj 2026 (Lufthansa Airlines)

Tiranë (TIA) – Varshavë (WAW) : 17:25 – 19:30

Varshavë (WAW) – Reykjavik (KEF) : 21:35 – 23:55

Fluturimi Islandë – Shqipëri 24 Maj 2026 (Lufthansa Airlines)

Reykjavik (KEF) – Varshavë (WAW) : 00:45 – 06:45

Varshavë (WAW) – Tiranë (TIA) : 10:30 – 12:40



ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI

Dita 1: Mbërritja në Islandë – Reykjavik

Udhetim ne Islande, rrugetimi drejt “tokës së zjarrit dhe akullit” nis me takimin me guidën rreth orës 15:00 në aeroport. Nisja nga Tirana bëhet në orën 17:25 dhe mbërrimë në Varshavë në orën 19:30. Më pas, marrim fluturimin drejt Reykjavikut në orën 21:35.

Do të zbresim në Aeroportin Ndërkombëtar të Keflavikut rreth mesnatës, në orën 23:55. Ndjesia e parë sapo të dalim jashtë është krejt unike: ajër i pastër, i ftohtë kristal, dhe qetësia e një vendi që duket sikur rri pezull mes realitetit dhe legjendave nordike. Pas procedurave, guidën tonë vendase do ta gjejmë në sallën e mbërritjeve, gati për të na shoqëruar drejt Reykjavikut, kryeqytetit modern, të gjallë dhe njëkohësisht magjik të Islandës.

Akomodimi në Fosshotel Reykjavik 4*.

Dita 2: Tur i Qytetit Reykjavik – Blue Lagoon

Pas mëngjesit në hotel, takojmë udhërrëfyesin tonë vendas dhe nisim eksplorimin e Reykjavikut, metropoli më verior i Europës. Turin do të kemi mundësi ta zhvillojmë në dy mënyra: me autobus dhe në këmbë, në mënyrë që të shijojmë ritmin e qytetit, arkitekturën unike dhe historitë që ai fsheh. Vizitojmë Qytetin e Vjetër, Parlamentin, Bashkinë dhe Portin e peshkimit. Do të admirojmë **Sallën ikonike të koncerteve Harpa**, një vepër arkitekture inspiruar nga kristalet islandeze, si dhe **Hallgrímskirkja**, simbolin e qytetit, që ngrihet madhështor në 74 metra lartësi dhe është frymëzuar nga format e lavës së kristalizuar pjesshëm.

Pas vizitës së qytetit, nisemi drejt një prej **25 Mrekullive të Botës Moderne** – Blue Lagoon. Ujërat e saj gjeotermalë, të pasura me silikë dhe minerale rigjeneruese, janë të famshme për ngjyrën e tyre magjike blu qumështore. Legjenda thotë se efekti i tyre shëron dhe zbut lodhjen – diçka që ne do ta shijojmë në çdo minutë.

Kthehemi në Reykjavik dhe e kemi pasditen të lirë për të shëtitur, për të provuar kuzhinën lokale ose thjesht për t’u çlodhur.

Akomodimi në **Fosshotel Reykjavik 4***.

Vaktet e përfshira: Mëngjesi



ITINERARI



Dita 3: Gadishulli Snæfellsnes – “Islanda në Miniaturë”

Pas mëngjesit, do të nisim eksplorimin e një prej rajoneve më të dashur për vendasit dhe më të fotografuar nga vizitorët: **Gadishulli Snæfellsnes**, i quajtur shpesh “Islanda në Miniaturë” për shkak të larminë së mahnitshme të peizazheve të tij.

Udhëtojmë mes fushave vullkanike, plazheve të bardha, shkëmbinjve dramatikë dhe maleve që ngrihen drejt qiellit. Ndalesa në **Arnarstapi** na çon pranë harqeve natyrore të shkëmbinjve dhe kolonive të zogjve detarë – një koncert natyror që të fut menjëherë në atmosferën e Islandës së egër dhe të paprekur. Në sfond shfaqet **Snæfellsjökull**, akullnaja legjendare që frymëzoi Jules Verne-n për “Udhëtim në Qendër të Tokës”.

Më pas arrijmë në një nga simbolet më të njohura të vendit – **Kirkjufell**, mali më i fotografuar i Islandës, së bashku me ujëvarën e tij të famshme **Kirkjufellsfoss**. Pamja këtu duket sikur vjen drejtpërdrejt nga një film fantastiko-shkencor.

Në mbrëmje kthehemi në Reykjavik.

Akomodimi në **Fosshotel Reykjavik 4***.

Vaktet e përfshira: Mëngjesi

Dita 4: Bregu Jugor – Ujëvara & Plazhe të Zeza

Pas mëngjesit, nisim aventurën përgjatë Bregut Jugor, një skenë e vërtetë natyrore ku Islanda shfaqet në versionin e saj më të egër dhe më të bukur.

Vizita e parë është tek Seljalandsfoss, një ujëvarë e një stili unik në botë pasi mund të ecim plotësisht pas saj, duke kaluar në një shteg që të çon brenda një zgavre shkëmbore. Të shohësh botën përmes një “perde uji” është një nga ato momente që nuk harrohen.

Më pas, vizitojmë Skógafoss, 60 metra e lartë dhe 25 metra e gjerë. Spërklart e ujit e shpesh krijojnë ylbere të dyfishta – thuhet se kush i gjen, do të ketë fat të mirë!

Udhëtimi vazhdon drejt **Reynisfjara**, plazhi i famshëm me rërë të zezë, ku Atlantiku përplasur furishëm mbi kolonat prej guri dhe formacionet magmatike të ngritura nga shpërthimet shekullore.

Gjatë rrugës për t’u kthyer në Reykjavik, ndalojmë te Sólheimajökull, një akullnajë e cila po ndryshon çdo vit si pasojë e klimës – një mundësi e rrallë për të ecur pranë lagunës së akullit dhe formacioneve të saj blu të thella.

Më pas, ofrohet një vizitë opsionale në Lava Center, një muze modern ku mund të shohim një film të shkurtër e tepër tërheqës për vullkanet islandeze – ideal për të kuptuar qartë pse Islanda është një laborator natyror gjeologjik.

Në fund të ditës, kthehemi në hotel për t’u çlodhur.

Akomodimi në **Fosshotel Reykjavik 4***.

Vaktet e përfshira: Mëngjesi

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



ITINERARI



Dita 5: Rrethi i Artë & Friðheimar

Pas mëngjesit në hotel, nisemi drejt **Rrethit të Artë (Golden Circle)**, një nga atraksionet më ikonike të vendit dhe një “must-see” për çdo vizitor.

Vizita e parë është **Haukadalur**, lugina ku ndodhen gejzerët e famshëm. Emri “gejzer” në të gjitha gjuhët e botës vjen nga fjala islandeze *Geysir* – ai që do të vizitojmë sot. Edhe pse aktualisht është joaktiv, **Strokkur** shpërthen çdo pak minuta, duke hedhur ujë të nxehtë deri në 20–30 metra lart.

Më tej, vizitojmë **Gullfoss – Ujëvara e Artë**, një kaskadë mbresëlënëse me dy nivele që derdhet fuqishëm në një kanion të thellë. Zhurma e saj dhe mjegulla që ngrihet ngjan si një perde ari, sidomos në ditët me diell. Më pas, kemi mundësinë të vizitojmë opsionalisht **serrën Friðheimar**, e famshme për prodhimin e domateve të rritura me energji gjeotermale. Një eksperiencë autentike islandeze, ku mund të shijojmë supë domatesh në mes të një sere tropikale.

Ndalesa e fundit është **Parku Kombëtar Thingvellir**, një vend me rëndësi të jashtëzakonshme gjeologjike dhe historike. Këtu mund të shohim me sy të lirë hendekun mes pllakave tektonike të Amerikës së Veriut dhe Euroazisë, të cilat largohen me rreth 2 cm çdo vit. Gjithashtu, ky ka qenë vendi ku parlamenti më i vjetër i Europës – Alþingi – mbledhej që prej vitit 930.

Në mbrëmje kthehemi në hotel për t’u përgatitur për darkën festive në Islandë. Pas darkës së lamtumirës, nisemi drejt aeroportit për fluturimin e orës 00:45.

Akomodimi në **Fosshotel Reykjavik 4*** (deri në nisje).

Vaktet e përfshira: Mëngjesi & Darka



DETAJET E SHËRBIMIT

Kategoria e Hoteleve: 4*

Numri i Ditëve: 5

Numri i Netëve: 4

Qytetet që vizitohen: 3: Reykjavik, Snæfellsnes, Golden Circle

Monumentet dhe Aktivitetet që vizitohen: Qyteti i Vjetër i Reykjavikut, Sallën e Koncerteve Harpa, Hallgrímskirkja, Blue Lagoon, Gadishulli Snæfellsnes, Arnarstapi, Kirkjufell dhe Ujëvara Kirkjufellsfoss, Ujëvara Seljalandsfoss, Ujëvara Skógafoss, Reynisfjara (plazhi i zezë), Akullnaja Sólheimajökull, Gejzerët e Haukadalur, Ujëvara Gullfoss, Friðheimar (serra e domateve), Parku Kombëtar Thingvellir, Sheshi i Parlamentit të Islandës

Aktivitetet: Shëtitje në qytet (Reykjavik), Pllaja me Rërë të Zezë në Reynisfjara, Eksplorim në Blue Lagoon, Shëtitje në Gadishullin Snæfellsnes, Vizita në akullnajën Sólheimajökull, Vizitë në Parkun Kombëtar Thingvellir, Vizitë opsionale në Lava Center

Mëngjese: 4

Darka: 1

Distanca e përshkruar: 740 km

Koha totale e transportit në rrugë tokësore: 10 orë

Distanca mesatare ditore: 148 km

Koha mesatare e transportit: 2 orë/ditë

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)

WWW.ELITETRAVEL.AL



REYKJAVIK – FOSSHOTEL REYKJAVIK 4*

MÍÐGARÐUR BY CENTER HOTELS 4* / GRANDI BY CENTER HOTELS 4*



ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



PËRSE TË UDHËTONI ME NE?

- Paketa të kuruara me kujdes për çdo moshë dhe interes
- Eksperiencia autentike kulturore në çdo destinacion. Cdo dite ka nje moment kulminant, qe eshte nje eksperience dhe nje aktivitet, Unesco Sites.
- Grupi optimal: 15–35 persona për një eksperiencë më personale
- Nuk ka kosto të fshehura – transparencë totale në çmim
- Fluturime të organizuara në grup me linja zyrtare per udhetime nderkontinentale ku bagazhet behen me checkin te plote pa dale nga aeroporti (jo low cost të papërshtatshme) – Bagazhet 23 KG gjithmone te perfshira
- Guida profesioniste dhe të përkushtuara, që flasin gjuhën tuaj
- 25 vite përvojë në organizimin e udhëtimeve cilësore
- Kujtime që zgjasin një jetë – jo thjesht një udhëtim
- Mbështetje 24/7 para, gjatë dhe pas udhëtimit
- Programe të pasura në përmbajtje kulturore dhe edukative
- Akomodim në hotele të përzgjedhura me standartin: 4 Superior / 5
- Vizat gjithmone te perfshira ne cmim

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



INFORMACIONE TË RËNDËSISSHME

Kushtet e Rezervimit dhe Pagesës

6.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti pranon të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për rezervimin e Shërbimit. Pagesa për Shërbimet do të bëhet nga Klienti në mënyrën e mëposhtme:

1. Depozita

- Konfirmimi i rezervimit. Pas konfirmimit të rezervimit, Klienti do të depozitojë shumën prej 25 % të kostos totale të Shërbimit të paketës EB. Kjo depozitë siguron rezervimin e Klientit dhe i lejon Agjencisë të fillojë të bëjë rezervimet e nevojshme.
- Depozitë e Parimbursueshme: 10% e shumës totale të udhëtimit nuk do të jetë e rimbursueshme në asnjë rast nga Operatori i shërbimeve përveç në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, siç është anulimi nga Operatori i shërbimeve ose ngjarjet e forcës madhore. Kjo politikë është në fuqi për të mbuluar çdo kosto të shkaktuar nga Operatori i shërbimeve në rast të një anulimi.
- Koha e Depozitës: Depozita duhet të bëhet jo më vonë se 10 ditë pas konfirmimit të rezervimit, kur rezervimi bëhet të paktën 3 muaj përpara. Kjo siguron që Operatori i shërbimeve të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për udhëtimin e Klientit.

2. Pagesa e pjesës së mbetur të kostos totale

- Pagesa finale: Bilanci i pagesës duhet të paguhet nga Klienti jo më vonë se 45 ditë para datës së fillimit të shërbimit. Kjo i lejon Agjencisë të konfirmojë të gjitha rezervimet dhe të finalizojë të gjitha përgatitjet.
- Pagesa të Vonuara: Moskryerja e pagesave në kohë mund të rezultojë në moskonfirmimin e rezervimeve pa njoftim të mëtejshëm. Kjo politikë është në fuqi për të siguruar që Operatori i shërbimeve të mund të përmbushë angazhimet e saj ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Tarifa për Pagesë të Vonuar: Në rast të pagesës së vonuar, Operatori i shërbimeve mund të vendosë një tarifë shtesë pagese prej 10% të shumës së papaguar. Kjo tarifë kompenson Agjencinë për punën shtesë administrative të përfshirë në trajtimin e pagesave të vonuara.

3. Për rezervimet e kryera/konfirmuara jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit:

Për të gjitha rezervimet e kryera brenda këtij afati (jo më herët se 45 ditë para nisjes së udhëtimit deri në ditën e nisjes), rezervimi quhet i konfirmuar në momentin që është kryer 100% e pagesës.

Anulimi dhe Rimbursimet

7.1 Për Shërbimin e paketës “Eksploro Botën”

Klienti mund të anulojë Shërbimet të paketës EB në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Njoftimi dhe Tarifat e Anulimit

1.Njoftim më shumë se 60 ditë: Anulimet e bëra më shumë se 60 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 10% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që mbulon kostot administrative që lidhen me anulimin e Shërbimeve të paketës EB.

2.Njoftim më pak se 59 ditë: Anulimet e bëra më pak se 59 ditë para datës së fillimit të shërbimit do të kenë një tarifë anulimi prej 40% të shumës totale të paketës së turit, tarifë që pasqyron vështirësinë e plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

3.Njoftim më pak se 30 ditë: Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai më pak se 30 ditë përpara udhëtimit, klientit nuk i kryhet asnjë rimbursim nga ana e kompanisë, tarifë që pasqyron vështirësinë në rritje të plotësimit të vendit të Klientit me një njoftim të shkurtër.

4.Mosparaqitje: Në rast mosparaqitjeje, nuk do të jepet rimbursim. Kjo politikë është në fuqi sepse Operatori i shërbimeve do të kishte bërë të gjitha rregullimet e nevojshme dhe nuk do të ishte në gjendje të rikuperonte këto kosto.

5.Anulimi i paketave të shërbimit për kategorinë “Eksploro Botën” mund të realizohet vetëm ndërmjet një kërkesë të paraqitur me shkrim, përmes emailit zyrtar, aplikacionit WhatsApp, ose me paraqitje fizike në zyrat e Elite Travel LCC Tiranë. Çdo kërkesë verbale, telefonike apo e paformalizuar me një dokument të shkruar nuk do të konsiderohet e vlefshme për procedurat e anulimit.

Me kryerjen e rezervimit dhe dërgimin e konfirmimit nga ana e Klientit, pavarësisht formës së tij (me shkrim, elektronik, përmes emailit, WhatsApp-it, pagesës së depozitës apo pagesës së plotë), kjo kontratë konsiderohet e pranuar plotësisht dhe pa asnjë kusht nga Klienti.

Ju lutemi për informacion më të detajuar vizitoni linkun për Kontratën me Klientin. [Klikoni këtu](#)

ELITE TRAVEL AGENCY

ELBASAN: RR. KOZMA NASKA, NR: 33/6, 3001 ELBASAN, ALBANIA
TIRANA: RRUGA E ATJONIT, TIRANË (PRANË SHKOLLËS ASIM VOKSHI)
WWW.ELITETRAVEL.AL



Elite Travel Agency

Everlasting Experiences

WWW.ELITETRAVEL.AL